

Për:	Operatorë Ekonomik: Shaip Mustafa B.i me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	10.03.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **03.03.2025**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Shaip Mustafa B.i** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizimi me material higjieniko – sanitar për shkollat e Komunës së Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-25-906-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-015-1-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Shaip Mustafa B.i** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizimi me material higjieniko – sanitar për shkollat e Komunës së Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-25-906-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-015-1-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **18.02.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Furnizimi me material higjieniko – sanitar për shkollat e Komunës së Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-25-906-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-015-1-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Shaip Mustafa B.i** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizimi me material higjieniko – sanitar për shkollat e Komunës së Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-25-906-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-015-1-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **18.02.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **03.03.2025**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE E KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR:

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt.18.02.2025, kurse hapja e ofertave është parashikuar të bëhet me dt. 11.03.2025.

Fillimisht po e sqarojmë se ne kemi parashtruar kërkesë për sqarime me datën 25.02.2025 mbrena afatit kohe për Sqarime të tenderit ,
Mirpo Ak nuk na është përgjigjur fare kete mund ta bashkangjesim me fakte shih foton:

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR:

Pretendimi ankimor i Operatori Ekonomik nuk qëndron!

Në lidhje me kërkesën tuaj nr. 1 të parashtruar për sqarime me datën 25.02.2025, dëshirojmë të sqarojmë se pretendimi se autoriteti kontraktues nuk ka dhënë përgjigje është i pavend. Autoriteti kontraktues ka kthyer përgjigje të detajuar për secilën pyetje të ngritur nga operatori ekonomik me datën 27.02.2025. Këto përgjigje janë të plota dhe janë ofruar brenda afatit të parashikuar për sqarime, sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Ne ju sigurojmë dokumentacionin dhe faktet përkatëse që vërtetojnë këtë përgjigje, përfshirë foton e bashkëngjitur që tregon komunikimin e bërë brenda afatit të kërkuar përmes e-prokurimit.

Prandaj, kërkesa e parashtruar nga ju nuk ka bazë, pasi përgjigjet janë ofruar në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullativë të prokurimit publik.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit